

# **Mbi Auditimin e Ushtruar në Agjensinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM)**

Raporti përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Agjensinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (Akzm), me Objekt “Mbi Zbatimin e Ligjshmërisë dhe Rregullshmërisë, Vlerësimi i Veprimtarisë Ekonomiko Financiare dhe Vlerësues” . nga data 01.01.2015 deri me datë 31.12.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 47, date 30.04.2016. Bazuar në nenet 15, 25 dhe 30 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. 1205/7, datë 06.05.2016 i është dërguar Agjensinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura “Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet”. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

## **A . MASA ORGANIZATIVE**

### ***1. Gjetje nga auditimi***

Në zbatim të Urdhrit të Ministrit, akoma nuk janë transferuar nga DRSHP dhe nuk janë marrë në dorëzim i gjithë dokumentacioni teknik dhe kontratat e lidhura për zonat e mbrojtura për qarqet Lezhë, Durrës dhe Vlorë. AKZM, nuk kishte një database të plotë të dhënash për të gjitha kontratat e lidhura kompetencë e DSHP-ve dhe detyrimeve që rrjedhin nga to, pasi kjo e fundit me krijimin e saj, ka për detyrë dhe përgjegjësi kontrollin e aktiviteteve që përdorin burimet natyrore, brenda rrjetit të zonave të mbrojtura. Mungesa e një baze të dhënash të plota e të përditësuara për kontratat e lidhura si dhe zvarritja e procesit të dorëzimit të tyre, ka bërë që ndërhyrjet në Zonat e Mbrojtura, të shtohen dhe në shumë raste këto zona janë dëmtuar tërësisht, duke u futur në listën për tu hequr si zona të mbrojtura. *(trajtuar në faqet 10-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

***Sa më sipër, është rekomanduar:***

AKZM duhet në mënyrë të menjëhershme të përfundojë procesin e dorëzimit dhe të identifikimit të kontratave në ZM. Ajo duhet të përcaktojë qartë një sistem menaxhimi për ZM, të cilit t’i përmbahet me rigorozitet, sipas radhës: Identifikimi, Planifikimi, Menaxhimi, Monitorimi dhe Raportimi. Kjo radhë, të shoqërohet me plane strategjike dhe përcaktim të qartë objektivash për ti kthyer këto zona në statusin e dikurshëm. Gjithashtu, të merren masa që AKZM të planifikojë një hartë risku, e cila të përmbajë listën e Zonave më të rrezikuara.

***Menjëherë***

### ***2. Gjetje nga auditimi***

Rëndësia e ekzistencës dhe ruajtjes së zonave të mbrojtura në thelb ka të bëjë me gjenerimin e përfitimeve ekonomike, sociale dhe mjedisore, përfitime të cilat kanë rezultuar shumë të vakëta për periudhën në auditim, për shkak të kohës së shkurtër të ekzistencës së këtij institucioni si dhe mungesës së një mbështetjeje institucionale nga strukturat më të larta të sistemit të zonave të mbrojtura, për të imponuar tek institucionet e varësisë zbatimin e ligjit për këtë çështje. Sot, AKZM administron dhe menaxhon biletat hyrëse në Parqet Kombëtare Mali i Dajtit, Mali Tomorit, Lurë si dhe biletat hyrëse në Monumentin Natyror “Syri i kaltër” dhe “Rezervatin e menaxhuar” Kune-Vain”(trajtuar në faqet ... të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

***Sa më sipër, është rekomanduar:***

Duke marrë parasysh mos përfitimin e të ardhurave nga shitja e biletave, AKZM-ja së bashku me AdZM përkatëse sipas qarqeve, të marrin masa për hartimin e projekteve për promovimin e zonave të mbrojtura dhe vendosjen e sistemit të biletave në mënyrë që të rritet vizitueshmëria e tyre, duke gjeneruar kështu më tepër të ardhura nga to. Po në këtë kontekst, në mungesë të fondeve të nevojshme akorduar nga buxheti i shtetit, AKZM përveç burimeve të brendshme të financimit nga administrimi i ZM duhet të llojë për donacione e grande të ndryshme nëpërmjet argumenteve bindëse cilësore dhe sasiore për përvetësimin e masës së parashikuar nga ligji për pyjet dhe shërbimin pyjor prej 70% të të ardhurave me qëllim rritjen e investimeve në ZM, mbrojtjen e faunës dhe të biodiversitetit dhe krijimin e kushteve për kryerjen e veprimtarive turistike dhe çlodhëse.

## *Vazhdimisht*

### **3. Gjetje nga auditimi**

Nga auditimi i kontratave të lidhura nga ish DSHP-të për dhënien e fondit pyjor, një pjesë e të cilave administroheshin në AKZM, rezultoi se përveç rasteve të parashikuara në ligj si për qëllime pushimi, argëtimi, për mbarëshkrimin e florës dhe faunës së egër, për gjueti, turistike etj., janë evidentuar edhe kontrata të lidhura në zonat e mbrojtura me subjekte private për Gurorë për prodhim materialesh inerte në karrierë, për impiante uji të pijshëm, për ndërtime HEC-esh, për nxjerrje minerale, vendosje antenash, të cilat janë lidhur nga DSHP në kundërshtim me ligjin Ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura” i ndryshuar. Vetëm në Qarkun e Gjirokastrës janë lidhur tre kontrata 10 vjeçare dhe një kontratë 1 vjeçare me subjektin “H” dhe dy kontrata 10 vjeçare me subjektin “L” të cilat i shërbejnë ndërtimit të HEC -ve “Gostivisht”, “Langarica 3”, “Ura e Dashit” dhe ndërtimit të linjës elektrike që lidh HEC me rrjetin kryesor të Përmetit. Këto kontrata janë dhënë në zonë të mbrojtur b) “Zonë e përdorimit të qëndrueshëm”, të “Parkut kombëtar” të ekosistemit natyror bredhi i Hotovës-Dangëlli me sipërfaqe të zgjeruar”. Në këtë zonë përfshihen habitate, pyjore e kullosore, pothuajse përreth zonës qendrore, për të cilën ajo shërben *si zonë buferike* ( *trajtuar në faqet 10-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### ***Sa më sipër, është rekomanduar:***

-Përmirësimet ligjore dhe zbatimi i sanksioneve duhet të sigurojnë një mbrojtje efikase për zonat e mbrojtura, duke mos lejuar veprimtaritë që shkaktojnë ndryshimin e gjendjes natyrore të ekosistemit në to. AKZM, në mënyrë të menjëhershme duhet të bashkëpunojë me AKM-në dhe MM, për të qartësuar sa më shpejt, nëse zhvillimi i këtyre aktiviteteve është i pajisur me leje mjedisore apo jo. Gjithashtu ajo duhet të themelojë një sistem ligjor të rreptë për mbrojtjen e ZM në projektligjin e ri që është duke hartuar.

-AKZM përveç zbulimeve të bëra nga grupi i auditimit, të zhvillojë më tej këtë proces dhe të marrë masa për identifikimin e të gjitha kontratave në zona të mbrojtura dhe të nxjerrë përgjegjësitë për ish titullarët e DSHP-ve për lidhjen e këtyre kontratave.

-Për këtë proces dhe të gjitha shkeljet e tjera ligjore të rezultuara në zonat e mbrojtura si ndërtimet pa leje, aktivitete pa leje, etj., të hartohet një raport përfundimtar i shoqëruar me masat përkatëse të propozuara për riparimin dhe mundësitë e eliminimit të ndërhyrjeve apo shkeljeve ligjore dhe të njoftohen strukturat me kompetencë vendimmarrje në këtë proces: Kryeministri, Ministri i Mjedisit, INUK, ISHMP, ALUIZNI sipas përgjegjësisë dhe funksioneve institucionale për vendimmarrjet përkatëse. Për rastet e mos veprimeve apo vendimmarrjeve të pa realizuara të informohen hap pas hapi Ministri i Mjedisit dhe Kryeministria.

## *Menjëherë*

### **4. Gjetje nga auditimi**

Nga mos menaxhimi i mirë i kontratave nga ish DSHP dhe tashmë AdZM, vetëm për vitet objekt auditimi 2014-2015, janë krijuar detyrime në shumën 8,998.9 mijë lekë, të cilat kanë ardhur nga mos pagesat në kohë të qirave vjetore dhe penaliteteve të krijuara në ditë vonesat në pagesë, (trajtuar në faqet 10-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

***Sa më sipër, është rekomanduar:***

-AKZM të marrë masa për identifikimin e të gjitha kontratave me detyrime të pa arkëtuara dhe ish titullarët të DSHP-ve me përgjegjësi në këtë drejtim për detyrimet nga mos pagesa në kohë e qirave, që nga momenti i lidhjes së kontratave (edhe para viteve 2014-2015) të cilët me veprimet dhe mosveprimet e tyre kanë lejuar rritjen e detyrimeve kontraktuale dhe për këtë të informohet MM për nxjerrjen e përgjegjëseve.

-Drejtoria e Menaxhimit dhe Monitorimit të projekteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme, të ndjekin procedurat për arkëtimin e detyrimeve të subjekteve që nga lidhja e kontratave për marrjen në përdorim të sipërfaqeve në zonat e mbrojtura ose në rast të kundërt të kërkojnë në rrugë ligjore prishjen e kontratave të lidhura nga ish DSHP-të me këto subjekte.

***Vazhdimisht***

***5. Gjetje nga auditimi***

Referuar faktit se nga titullari i autoritetit kontraktor nuk janë ngritur komisione për marrjen në dorëzim të mallrave të furnizuara për çdo rast në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimin i MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, (trajtuar në faqet 46-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

***Sa më sipër, është rekomanduar:***

-Të merren masa nga Titullari i AKZM-së për ngritjen e komisionit për çdo rast të marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

***Në vazhdimësi***

***6. Gjetje nga auditimi***

Referuar faktit se nga AKZM, janë realizuar shpenzime për dieta dhe dokumentacioni bashkëlidhur dietave nuk ishte korrekt, referuar kërkesave të vendimit të KM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” të ndryshuar, (trajtuar në faqet 46 -56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit), ***Sa më sipër, është rekomanduar:***

- Nga ana e AKZM nisur nga fakti i pa bazueshmërisë ligjore të kryerjes së këtyre pagesave, të kërkojë domosdoshmërisë plotësimin ligjor dhe korrekt të dokumentacionit dhe ti qëndrojë faktit të kryerjes së shpenzimeve për dieta, vetëm ditëve zyrtare të punës dhe konform distancave kilometrike që parashikohen këto shpenzime.

***Menjëherë***

***7. Gjetje nga auditimi***

Emërimi i punonjësve të AKZM-së është bërë nga Ministri i Mjedisit referuar “Kodit të punës për Administrata e Zonave të Mbrojtura, mbështetur në strukturën e miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 39 date 12.03.2015,” Për miratimin e Strukturës dhe organikes se AKZM dhe AdZM- ve”. Gjithashtu në zbatim të urdhrin të Ministrit të Mjedisit nr. 87, datë 13.03.2015 janë transferuar 178 punonjës nga Drejtoritë e Shërbimeve Pyjore në AdZM dhe AKZM. Në këtë proces, emërimet prej 20 punonjësish për nivelin qendror(AKZM), kanë

*anashkaluar çdo procedure dhe konkurrence, duke u bërë në kundërshtim me ligjin 152/2013 date 01.10.2013 dhe Vendimin nr. 106 date 04.02.2015 kreu V, pika 1 , në të cilin citohet se marrëdhëniet e punës së nëpunësve të AKZM-së, rregullohen sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", (trajtuar në faqet 39-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

***Sa më sipër, është rekomanduar:***

- AKZM në të ardhmen të ndjek të gjithë hapat e nevojshëm për rekrutim, duke zbatuar ligjin nr. 152/2013 date 01.10.2013" Për procedurat e statusit të nëpunësit civil dhe aktet në zbatim të tij.

-Të vazhdojnë procedurat me DAP për përfshirjen e gjithëve punonjësve aktualisht në punë të AKZM në procedurat e emërimit me statusin e nëpunësit civil.

-Të ndiqen të gjitha procedurat e vlerësimit të performancës së punonjësve të AKZM-së si pjesë e rëndësishme performancës individuale të punonjësit, në zbatim të ligjit të nëpunësit civil.

***Menjëherë***

***8. Gjetje nga auditimi***

Nga auditimi ka rezultuar se në AdZM ka të punësuar punonjës, që nuk kanë arsimin e duhur në pozicionet Roje Mjedisore në 7 raste me arsim 8 vjeçar, në pozicionin e përgjegjës sektori dhe specialist me arsim të mesëm në kundërshtim me strategjinë e Agjencisë si dhe vendimit nr. 455, datë 18.07.2009 i ndryshuar me vendimin nr. 552 datë 11.08.2011 lidhja nr. 2 "Për pagat dhe shtesat mbi page të punonjësve të shërbimit pyjor ", ku nuk parashikohen paga për punonjës me nivel të tillë arsimor, (trajtuar në faqet 39-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit). ***Sa më sipër, është rekomanduar:***

-AKZM të marrë masat e nevojshme në zëvendësimin dhe rekrutimin e punonjësve në të ardhmen me arsimin përkatës për çdo pozicion pune.

***Menjëherë***

***9. Gjetje nga auditimi***

Nga auditimi u konstatua se punonjësve të AKZM-se në kundërshtim me ligjin nr. 8097, datë 21.03.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", i ndryshuar, ligjin nr. 9990 date 15.09.2008, neni 1 pika 9, nuk u janë mbajtur për vitin 2015 nga paga mujore, sigurimet shtetërore suplementare, (trajtuar në faqet 39-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

***Sa më sipër, është rekomanduar:***

- AKZM të ndërmarrë hapat përkatëse referuar kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 499, datë 21.09.2000 pika 3 dhe 4 për përfshirjen e punonjësve të institucionit në listën e punonjësve me detyrim të pagesave të sigurimeve suplementare, konform ligjit.

***Menjëherë***

***10. Gjetje nga auditimi***

Nga auditimi u konstatua se nga mos pagimi dhe deklarimi në kohë për shumën e vetë deklaruar të kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, nëpërmjet faqes zyrtare të Tatim Taksave, rezulton që për vitin 2015, AKZM i janë aplikuar gjopa në vlerën 774,472 lekë dhe interesa të pa paguar në vlerën 35,167 lekë, gjithsej në shumën 809,639 lekë deri në datën 20.02.2016, (trajtuar në faqet 39-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

***Sa më sipër, është rekomanduar:***

-Nga zyra e financës së AKZM të marren masat përkatëse për rakordimin e këtyre vlerave sipas përcaktimeve ligjore. Detyrimet në vlerën 809,639 lekë duhet të korrektohen dhe rakordohen me organin e Tatim Taksave në mënyre të menjëhershme.

***Menjëherë***

***11. Gjetje nga auditimi***

Nga auditimi i kryer ka rezultuar se nuk është hartuar dhe mbajtur në mënyre periodike libri i pagave në institucion, referuar Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, (*trajtuar në faqet 39-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*). ***Sa më sipër, është rekomanduar:***

- AKZM të marre masat për hartimin e librit të pagave për çdo punonjës dhe të kryej azhurnimin e tij për çdo vit kalendarik.

***Menjëherë***

***12. Gjetje nga auditimi***

Nga auditimi u konstatua se disa nga dosjet e punonjësve të marrë rishtas në punë, kanë mungesa dokumentacioni. Gjithashtu dosjeve të personelit u mungonte inventari mbi përmbajtjen e tyre, në kundërshtim kjo me kërkesat e ligjin nr. 152/2013 “ Për nëpunësin civil” dhe kërkesat e vendimit nr. 117, datë 05.03.2014 “ Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, (*trajtuar në faqet 39-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

***Sa më sipër, është rekomanduar:***

-Zyra e burimeve njerëzore të AKZM të marrë masa në plotësimin dhe mbajtjen e dosjeve të personelit në përputhje me kërkesat e vendimit nr. 117, datë 05.03.2014 “ Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, ku të përcaktohen të dhënat teknike të përmbajtjes së fletës prezantuese dhe inventari i dosjes. Gjithashtu dosjet duhet të përmbajnë dhe çdo dokumentacion të kërkuar nga aktet ligjore në fuqi.

***Menjëherë***

***13. Gjetje nga auditimi***

Referuar faktit se nga AKZM, si institucion i ri i krijuar gjatë vitit 2015, nuk janë hartuar dokumenti i deklaratës së vetëvlerësimit dhe raporti i cilësisë së funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, i cili dërgohet zyrtarisht në Ministrinë e Mjedisit dhe në Ministrinë e Financave, për efekte të plotësimit me rigorozitet të kërkesave të nenit 18 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 dhe nisur nga fakti se këto dokumente japin opinione të rëndësishme mbi funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit brenda institucionit, (*trajtuar në faqet 63-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*), ***Sa më sipër, është rekomanduar:***

-Nga AKZM duhet që për deklaratimet për periudhat në vazhdim, të cilat bëhen në institucionet përkatëse brenda muajit Shkurt të vitit pasardhës, në plotësim të kërkesave ligjore, të dorëzojë pyetësozin e vetëvlerësimit për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit së bashku me deklaratën dhe raportin e cilësisë.

***Vazhdimisht***

***14. Gjetje nga auditimi***

Referuar konstatimit nga auditimi, se në AKZM nuk kishte rregulla të brendshme të miratuara për gjurmët e auditimit për procedurat standarde të përdorimit të fondeve buxhetore, për shpenzimet për paga, operative sipas llojit, për administrimin e aseteve dhe materialeve të institucionit si dhe të procedurave të prokurimit publik, me synim që të sigurohet se të gjitha operacionet e njësisë publike, dokumentohen në atë formë, që u

mundëson audituesve të brendshëm e të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit, *(trajtuar në faqet 63-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit),*

***Sa më sipër, është rekomanduar:***

-Nga N/A dhe Titullari i institucionit, ku aktualisht në AKZM nëpunësi autorizues është dhe Titullar institucioni, në zbatim të nenit 9, pika 2 dhe nenit 16, pika 2, të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të hartohen dhe të miratohen rregullat për gjurmët e auditimit, për procedurat standarde të shpenzimeve, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Financave në zbatim të ligjit të MFK

***Menjëherë***

***15. Gjetje nga auditimi***

Gjatë auditimit të vlerësimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, u konstatua se:

Nuk monitorohen nga Titullari dhe strukturat e tij, njësitë në varësi(AdZM) mbi efektivitetin e të gjitha sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të këtyre njësive, *(trajtuar në faqet 63-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

***Sa më sipër, është rekomanduar:***

- Të monitorohen nga Titullari dhe strukturat e tij, efektiviteti i të gjitha sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të institucioneve të varësisë (AdZM) dhe të raportohet për efektivitetin e këtij sistemi sidomos në drejtim të përdorimit të bazës materiale dhe nevojave për to. Ky monitorim të bëhet dhe për procesin e hartimit të programeve buxhetore afatmesme dhe vjetore si dhe monitorimin e realizimit të objektivave dhe produkteve dhe fondeve të harxhuara për realizimin e tyre.

***Vazhdimisht.***

***16. Gjetje nga auditimi***

Nga auditimi për periudhën objekt auditimi është konstatuar se, zyra e financës së AKZM ka paguar detyrimet për shërbim postar për të 12 rajonet pa konfirmuar dokumentin e kryerjes së këtij shërbimi nga punonjësit që e realizojnë dhe menaxhojnë këtë shërbim (akt rakordim apo konfirmim fature të lëshuar nga Posta Shqiptare). Për efekt të shmangies së pagesave për shërbime të pa kryera, *(trajtuar në faqet 46-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit),*

***Sa më sipër, është rekomanduar:***

-Nga zyra e financës së institucionit, referuar udhëzimeve të Ministrisë së Financave në fuqi, për një menaxhim sa më efektiv të fondeve buxhetore, të kryhen pagesat vetëm mbas sigurimit të të gjithë dokumentacionit të konfirmuar vërtetues, e të mjaftueshëm të kryerjes së shërbimit.

***Menjëherë***

***17. Gjetje nga auditimi***

Nga auditimi i procedurave të kryerjes së shpenzimeve nëpërmjet bankës dhe arkës në AKZM, nuk rezultuan pagesa për ujë dhe drita. Vetë administrata e AKZM i kryhen funksionet e saj në mjediset e MM. Nisur nga fakti se në vartësi të AKZM për kryerjen e funksioneve të AdZM kanë kaluar shumë ambiente që administroheshin nga ish Drejtoritë e Shërbimit Pyjor, të cilat kanë qenë me funksione administrative dhe financiare më vete dhe se prej tyre janë trashëguar detyrime për energji dhe ujë, por edhe detyrime të reja të lindura gjatë vitit 2016, për të cilat është përgjegjëse AKZM, *(trajtuar në faqet 46-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit),*

***Sa më sipër, është rekomanduar:***

-Nga AKZM me procesin e kalimit në përgjegjësi administrimi të pronave të ish DSHP, të kryhen rakordimet me OSHEE si dhe me Ndërmarrjet e Ujësjetllës Kanalizimeve në të cilat kjo Agjenci ka zyrat rajonale, për hapjen e kontratave në emër të saj dhe kryerjen e pagesave sipas afateve konform ligjit.

**Menjëherë**

### **18. Gjetje nga auditimi**

Referuar faktit të konstatuar nga auditimi se në fletë udhëtimet e mbajtura, nuk janë evidentuar destinacionet përfundimtare të udhëtimit në rrethet përkatëse, duke u nisur dhe nga specifikat që ka ky institucion në mbrojtje, monitorim dhe menaxhim të zonave të mbrojtura (pra destinacione larg qendrave urbane), referuar dhe faktit të një numri të konsideruar mjetesh motorike me fuqi të ndryshme ( motorë, autovetura , motobarka, etj ) të cilat kanë dhe konsume të ndryshme lëndësh djegëse, për efekt të përdorimit me efektivitet dhe të shmangies së interpretimeve jo të bazuara në dokumente dhe jo korrekte me aktet në fuqi, (trajtuar në faqet 46-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit),

**Sa më sipër, është rekomanduar:**

**a.** Të bashkëpunohet me Ministrinë e Transporteve si dhe Inspektoratin Qendror për të marrë referencat e distancave kilometrike brenda rrethit, të cilat nuk janë të publikuara zyrtarisht.

**b.** Në fletët e udhëtimeve, të cilat janë dokumente që justifikojnë itinerarin e përshkruar, të vendosen destinacionet përfundimtare të udhëtimit dhe çdo fletë udhëtimi të konfirmohet nga punonjësit udhëtues i autorizuar.

**c.** Nga AKZM të bëhet një studim i shpërndarjes efektive të mjeteve në përdorim dhe administrim të AdZM, në funksion të shtrirjes , hapësirave, rëndësisë, risqeve të zonave të mbrojtura, me qëllim realizimin e funksioneve të ruajtjes, mbrojtjes, monitorimit e menaxhimit sa më efektiv të tyre.

**Menjëherë**

### **19. Gjetje nga auditimi**

Referuar konstatimit se në AKZM në dokumentet justifikues të shpenzimit në blerjet e vogla, nuk ndodhëj dokumentacioni i cili vërtetonte llogaritjen e fondit limit, referuar dhe faktit të konstatuar, se në disa raste të llogaritjeve aktuale, fondi limit nuk përcaktohej sipas manualeve të ndërtimit në fuqi, (trajtuar në faqet 46-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit),

**Sa më sipër, është rekomanduar:**

-Nga njësia e prokurimit të merren masat që llogaritja e fondit limit konform akteve në fuqi, të kryhet dhe dokumentohet si procedurë. Dokumentacioni argumentues i llogaritjes së fondit limit të jetë pjesë e praktikës së procedurës së prokurimit.

**Vazhdimisht**

### **20. Gjetje nga auditimi**

Referuar faktit të konstatuar se nga Drejtoria Ekonomike në AKZM nuk ka përfunduar mbyllja e pasqyrave financiare si rezultat i mos mbylljes së llogarive kontabël; mos përfundimit së procesit të inventarizimit të aktiveve të transferuara, të përfituara nga projektet e huaja , apo nga procesi i shkrirjes së Drejtorive të Shërbimit Pyjor, si dhe referuar faktit të daljes së materialeve nga magazina vetëm me konfirmimet e N/Z të AKZM, (trajtuar në faqet 56-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit),

**Sa më sipër, është rekomanduar:**

-Mbylljen e pasqyrave financiare dhe gjithë dokumentacionit të nevojshëm për to për veprimet financiare dhe zyrtare të vitit 2015, në periudhën më të afërt të vitit 2016 dhe njoftimin dhe vënien në dispozicion të KLSH të këtij dokumentacioni.

-Marrjen e masave dhe nxjerrjen e përgjegjësive materiale, duke ndjekur rrugët ligjore për inventarët e rezultuara të humbura, vjedhura të shpërdoruara, apo të pa bëra dorëzim nga përfitimi i projektit "X" si dhe futjen në kontabilitet të vlerave të këtij inventari konform gjithë dokumentacionit ligjor në fuqi.

- Hartimin dhe konfirmimin e dokumentacionit të nevojshëm për daljet nga magazina. Çdo dalje nga magazina duhet të ketë autorizimin e N/A, në zbatim të udhëzimit të MF me nr. 30, datë 27.12.2011” Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik”.

*Menjëherë*

## **21. Gjetje nga auditimi**

Gjatë auditimit u konstatua se në kundërshtim me nenet 39 dhe 75 të ligjit nr. 9936, date 6.6.2008 “ Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nga Ministria e Mjedisit është mbajtur jashtë sistemit të thesarit, llogari e arkëtimit të të ardhurave për kontratat e lidhura nga DSHP, ku për kontratat në vazhdim dhe ato të lidhura gjatë vitit 2015 do të jetë administruese dhe monitoruese AKZM. Kjo llogari e hapur që në vitin 1998 me aktet përkatëse, me hyrjen në fuqi të ligjit të mësipër duhej të mbyllej, në një kohë që vazhdon të jetë e hapur dhe në momentin e auditimit të AKZM. Gjithashtu u konstatua se për shumat e arkëtuara dhe depozituara në llogarinë jashtë thesarit, e cila në fund të vitit 2014 kishte një gjendje prej 184.7 milion lekë dhe në fund të vitit 2015 kishte një gjendje 326. 57 milionë lekë, nuk ka përdorime për një pjesë të konsiderueshme të arkëtimeve për vitin 2014 dhe për asnjë arkëtim të realizuar gjatë vitit 2015, përdorim i cili duhej të bëhej sipas destinacioneve të përcaktuara në ligjin nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”. Këto fonde kanë mbetur në llogarinë jashtë sistemit, në një kohë që nga fondet buxhetore të çelura për MM në kapitullin 1 dhe programet përkatëse për pyjet, janë përdorur shumat prej 60.98 milionë lekë në 2014 dhe 178.96 milionë lekë në vitin 2015. Gjithashtu është konstatuar se për fondet e arkëtuara në llogarinë jashtë thesarit në bankën e nivelit të dytë, nuk janë aplikuar nga banka interesat për vitin 2014 dhe 2015 në ndryshueshmëri me vitet e mëparshme, *(trajtuar në faqet 10-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

### ***Sa më sipër, është rekomanduar:***

-Nga Ministria e Mjedisit të mbyllet në mënyrë të menjëhershme llogaria jashtë sistemit të thesarit konform akteve në fuqi, ku shumat gjendje në llogari të transferohen në sistemin e thesarit.

- Nga Ministria e Mjedisit konform marrëveshjeve që ka Ministria e Financave me bankat e nivelit të dytë për veprimet me qeverinë dhe konform përcaktimeve të hapjes së llogarisë rrjedhëse në vitin përkatës, të kërkohet aplikimi i interesave për shumat e pa aplikuar, për një pjesë të arkëtimeve të vitit 2013, për arkëtimet e vitit 2014, 2015 dhe 2016.

- Nga AKZM në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, referuar kontratave në administrim të saj, të njoftojnë zyrtarisht subjektet e kontraktuar me kontrata në fuqi, për numrat e llogarisë ku do të depozitohen këto të ardhura, *brenda sistemit të thesarit*.

- Nga AKZM në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, në kuadrin e ndryshimeve të tjera ligjore në përcaktimin e kompetencave të AKZM për pyjet dhe zonat e mbrojtura, të përcaktohen gjithashtu e drejta e përdorimit të të ardhurave në drejtim të financimeve për mbrojtjen, përmirësimin, mirë menaxhimin të ZM në përputhje me objektivat, qëllimin dhe funksionet e përcaktuara për AKZM në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 4.02.2015.



*Menjëherë*

## **22. Gjetje nga auditimi**

Nga auditimi u konstatua struktura e AKZM-së dhe AdZM-ve e miratuar nga Kryeministri me urdhrin nr. 39, datë 12.03.2015 nuk ka të përcaktuar klasat dhe kategoritë e pagave, (trajtuar në faqet 39-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **Sa më sipër, është rekomanduar:**

-AKZM të ndërmarrë hapat e duhur ligjor për miratimin e strukturës me të gjithë klasat e kategoritë përkatëse për çdo pozicion pune në organet kompetente, duke mënjanuar kështu në të ardhmen interpretimin ndryshe të zbatimit të vendimeve në fuqi për pagat.

*Menjëherë*

## **23. Gjetje nga auditimi**

Nga auditimi në AKZM, rezultuan pasaktësi të ndryshme në zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave në fuqi në drejtim të zbatimit të pagave në nivel qendror dhe rajonal. Kështu nga mospagimi i strukturave rajonale në përputhje me vendimin KM nr. 736, datë 09.09.2015, për disa ndryshime të vendimit nr. 545, datë 11.08.2011 të KM, ku në pikën nr.2 përcaktohet se punonjësit e Administratave të Zonave të Mbrojtura do të vazhdojnë të paguhet sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të shërbimit pyjor është shkaktuar një dëm ekonomik për periudhën e audituar në shumën rreth 7,088,821 lekë, dhe ku nga AKZM argumentohet se është zbatuar urdhri i Ministrit të Mjedisit nr. 1757, datë 15.04.2014,(trajtuar në faqet 39-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **Sa më sipër, është rekomanduar:**

-Nga AKZM në mënyrë të menjëhershme të korrektohen pagesat e punonjësve për periudhën në vijim, në zbatim të vendimeve të Këshillit të Ministrave në fuqi, referuar lidhjeve përkatëse si dhe kategorive përkatëse të pagave të përcaktuara për administratat rajonale të AdZM si dhe administratën e AKZM.

*Menjëherë*

## **24. Gjetje nga auditimi**

Në krahasim me Zonat e Mbrojtura, plani i menaxhimit të tyre rezulton në një numër mjaft të ulët. Konkretisht në 15 zona të miratuara në kategorinë “Rezervat Natyror” dhe “Park Kombëtar”, rezultojnë 3 prej tyre janë miratuar plane menaxhimi, ndërsa në 23 zona të miratuara “Rezervat Natyror i Menaxhuar” dhe “Peizazh i Mbrojtur”, në 4 prej tyre janë miratuar plane menaxhimi, (trajtuar në faqet 75-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **Sa më sipër, është rekomanduar:**

- Nga AKZM të merren të gjitha masat organizative dhe financiare për hartimin e planeve të menaxhimit për të gjithë zonat e mbrojtura. Pjesë e rëndësishme e programit të AKZM duhet të jenë edhe:

i. Rishikimi i ligjit për Zonat e Mbrojtura dhe i akteve nënligjore, nën fokusin e zhvillimeve të reja dhe të vizionit të IUCN-së.

ii. Rishikimi i planeve të menaxhimit, jo vetëm i atyre që u ka kaluar afati, por veçanërisht planet që janë hartuar gjatë viteve 2010-2014, duke saktësuar përgjegjësitë e miratimit dhe të përdoruesve të tyre.

iii. Rishikimi i përbërjes së Komiteteve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura, duke caktuar përgjegjësitë e anëtarëve të këtij komiteti, të cilët të kenë një rol më aktiv dhe jo vetëm konsultativ.

iv. Sigurimin e plotë të përafrimit dhe zbatimit të dy direktivave bazë të BE-së: Të Habitatit dhe të Shpendëve, si dhe zhvillimin e Rrjetit Natyra 2000.

### **25. Gjetje nga auditimi**

Duke parë gjendjen aktuale të menaxhimit të Zonave të Mbrojtura dhe masat e përcaktuara, nxjerrim konkluzionin e përgjithshëm se Zonat e Mbrojtura të cilat zënë 16 % të sipërfaqes të përgjithshme të territorit, aktualisht janë pothuajse të agravuara në një nivel mjaft të lartë për rrjedhojë ato aktualisht janë të pambrojtura, (*trajtuar në faqet 75-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### ***Sa më sipër, është rekomanduar:***

- Prioritet i programit të AKMZ-së, duhet të mbetet analiza e mangësive në sistemin e Zonave të Mbrojtura në nivel kombëtar, bazuar edhe në kërkesat për sisteme përfaqësues të zonave të mbrojtura. Në programet e saj AKZM dhe strukturat e varësisë, duhet të parashikojë e të zbatojë një sërë mekanizmesh ligjorë, financiarë dhe institucionalë për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit. Këto mekanizma duhen orientuar sipas parimeve që burojnë nga konventat ndërkombëtare në fushën e natyrës dhe të biodiversitetit, të pasqyruara edhe tek Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin dhe Zonat e Mbrojtura, Plani Kombëtar të Integritimit në Evropë, si dhe në Programin e Qeverisë.

### ***Brenda muajit Dhjetor 2016***

### **26. Gjetje nga auditimi**

Problem mjaft shqetësues dhe mjaft shkatërrues për pyjet rezultojnë zjarret e përvitshme në Zonat e Mbrojtura e sidomos në Lurë, Qarkun e Shkodrës, Malin e Dajtit, Malin me Gropa-Bizë-Martanesh, Qafshtamë, Shebenik, Stravaj, Divjakë-Karavasta, Guri i Nikës, Liqeni i Pogradecit, Bredhi i Hotovës-Dangëlli, e në shumë zona të tjera, duke dëmtuar sipërfaqe mjaft të mëdha pyjesh të ndryshëm, (*trajtuar në faqet 75-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### ***Sa më sipër, është rekomanduar:***

- Përveç aspekteve të kontrollit nga ana e rojeve mjedisore duhet punuar edhe në drejtim të luftës kundër zjarreve. Me ardhjen e stinës së verës, duhet kërkuar nga të gjithë AdZM-të që në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe me institucionet e tjera, marrjen e masave mbrojtëse për parandalimin e zjarreve në pyje dhe kullota në zonat e mbrojtura si:
- Ngritja e sistemit të vrojtimit sinjalizimit për parandalimin e rënies së zjarreve në zonat e mbrojtura;
- Skema dhe grafikët të skuadrave zjarrfikëse të AdZM-ve në qarqe në bashkëpunim me pushtetin vendor;
- Bashkëpunim me strukturat lokale e të specializuara para fillimit të zjarreve.

### ***Menjëherë***

### **27. Gjetje nga auditimi**

Gjatë kontrolleve të kryera në terren nga AKZM dhe AdZM-të, rezulton se brenda rrjetit të Zonave të Mbrojtura janë konstatuar si më poshtë:

- Brenda rrjetit të Zonave të Mbrojtura janë identifikuar 71 HEC-e nga këto:
  - HEC-e që kanë qenë ndërtuar para viteve 90 rezultojnë 6 (gjashtë);
  - janë ndërtuar pas viteve 90 dhe që kanë filluar prodhimin 21 (njëzetënjë);
  - janë në proces ndërtimi 44 (dyzetekatër).

Vetëm në rrethin e Librazhdit janë ndërtuar dhe janë në proces ndërtimi gjithsej 40 HEC-e, (*trajtuar në faqet 75 -89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### ***Sa më sipër, është rekomanduar:***

- Nga AKZM të nxirren të gjitha lejet e dhëna për HEC-et dhe në bazë të koordinatave të nxirren sa prej tyre janë dhënë brenda Zonave të Mbrojtura dhe në bashkëpunim me AKM-në dhe Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, të qartësohet përfundimisht numri i tyre dhe dokumentacioni i dhënë për pajisjen me leje mjedisore. Të kryhet kontrolli për të saktësuar kontratat e lidhura dhe sistemet e koordinatave, njëkohësisht dhe sipërfaqet e dhëna dhe detyrimi për çdo HEC për sipërfaqen e mbjelljes me pemë. Nisur nga shqetësimet e krijuara në banorët e zonave, të evidentohen dhe problematikat e dala për ndërtimin e tyre.

- Për efekt të mbrojtjes së burimeve natyrore për vlerat natyrore që ato kanë, por dhe për vlerat efektive që kanë për zonën dhe banorët përreth tyre, rekomandojmë AKZM që me atributet e funksioneve institucionale që ajo zotëron në drejtim të mbrojtjes së zonave të mbrojtura, të propozojë në institucionin e linjës ndryshimet ligjore që lidhen me pikën d të nenit 39 të ligjit 111/2012, datë 15.12.2012 *“Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” ku ndryshimi të konsistojë në rritjen e % së sasisë së ujit të lënë e cila nuk mund të jetë më e vogël se prurja me qëndrueshmëri minimalisht 300 ditë në vit, mbasi është siguruar dhe nevoja e bujqësisë.*

***Menjëherë***

### **28. Gjetje nga auditimi**

Nga AKZM akoma nuk janë saktësuar zonat e dhëna për ndërtimin e HEC-ve sipas koordinatave përkatëse për të përcaktuar vendndodhjen e saktë të tyre brenda rrjetit të Zonave të Mbrojtura. Njëkohësisht akoma nuk janë marrë dosjet përkatëse me kushtet e lejeve ndërtimore për çdo HEC, fakt ky që e bën të pamundur kontrollin e lejeve mjedisore përkatëse, *(trajtuar në faqet 75-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### ***Sa më sipër, është rekomanduar:***

- Nga AKZM dhe AdZM të merren të gjitha dosjet e HEC-ve dhe të ndiqet në mënyrë të vazhdueshme monitorimi i aktiviteteve të HEC-eve në Zonat e Mbrojtura, në drejtim të zbatimit rigoroz të detyrimit të mbjelljes së numrit të pemëve të përcaktuara në kontratë.

Nga AdZM-të dhe AKZM të studiohet potenciali mbajtës për aktivitete të biznesit në zonat e kategorisë së V-të dhe VI-të, si dhe të monitorohet në mënyrë rigoroze sasia e marrjes së ujit për devijim për prodhim energjie dhe lënies së prurjes ekologjike prej 33 % në dobi të vetë sistemit ekologjik.

Ndërtimi i veprave të reja pavarësisht projekteve në miratim në zonat e kategorisë II-të-III-dhe IV-të, si dhe në shkallën e I-rë dhe të II-të (rasti Valbonë, Bencë, Osum dhe Korab), të jepen VNM sipas përcaktimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- Nga AKZM në kuadrin e përmirësimeve ligjore, të shprehet specifikisht në ligjin për zonat e mbrojtura, që në kategoritë II,III për të gjitha shkallët e mbrojtura ; për kategorinë IV për shkallën e parë dhe të dytë të mbrojtjes dhe për kategorinë V për shkallën e parë të mbrojtjes, të jetë e ndaluar ndërtimi i veprave si HEC-e, miniera, gurore dhe të tjera, që referuar veprimtarive të tyre të vërtetuara nga praktikrat e deritanishme, sjellin dëme të mëdha në sistemin shëndetësor, natyror dhe human të zonës përkatëse.

***Menjëherë***

### **29. Gjetje nga auditimi**

Gjatë kontrolleve të kryera nga AdZM-të për vitin 2015 janë konstatuar vende depozitim mbetjesh gjithsej 34 nga këto:

-Urbane/të ngurta janë 27.

-Vende me derdhje të ujërave të zeza janë 3.

-Mbetje industriale janë identifikuar 4.

AKZM-ja së bashku me AdZM-të kanë ushtruar kontrolle të vazhdueshme në këto vatra dhe ka konstatuar se në pikat e mbetjeve urbane, shqetësuese është pastrimi i mbetjeve mbas kryerjes së aktiviteteve që organizohen në raste takimesh e festash. Problematike është dhe ndotja e sipërfaqeve nga mbetjet e ngurta sidomos në vendet që kryhen punime për HEC-et apo dhe rikonstruksione të ujësjellësve. Shqetësim ka dhe në zonën e mbrojtur të Liqenit të Pogradecit, ku vend depozitimi i hekur nikelit në afërsi të Gurit të Kuq përbën një pikë të nxehtë. Përsa i përket ndotjes nga ujërat e zeza shqetësuese është derdhja e ujërave nga banorët e fshatit Pustec e Goricë e Vogël që ndodhet në Prespë, *(trajtuar në faqet 75-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

***Sa më sipër, është rekomanduar:***

- AKZM, të koordinojë punën me AdZM dhe në bashkëpunim me Inspektoratin e Mjedisit dhe Inspektoratin e Ndërtimit sipas qarqeve të marrin të gjitha masat administrative sipas dispozitave ligjore në fuqi kundrejt shkelësve të ligjit.

***Vazhdimisht***

### ***30. Gjetje nga auditimi***

Gjatë gjithë periudhës së vitit 2015 pranë AKZM-së janë regjistruar 280 procesverbale të konstatimit të dëmit në zonat e mbrojtura, nga të cilat 67 procesverbale konstatimi me autor dëmi të mbajtura nga rojet mjedisore në AdZM-të e qarqeve, të cilat janë nisur ISHMP-ve për ndjekjen e mëtejshme të procedurave. Numri i ulët i procesverbaleve të konstatimit me autor dëmi në krahasim me numrin në total prej 280 procesverbale ose me një realizim prej 24 % tregon për punë të dobët të rojeve mjedisore të AdZM-të e qarqeve, *(trajtuar në faqet 75-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

***Sa më sipër, është rekomanduar:***

- Nga AKZM të forcohet kërkesa e llogarisë për realizimin e detyrave funksionale të AdZM në drejtim të shtimit të procesverbaleve me autor dëmi, duke rritur numrin e tyre në raport me totalin e dëmeve të konstatuara.

***Vazhdimisht***

### ***31. Gjetje nga auditimi***

Deri në periudhën e përfundimit të auditimit nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit nuk i është dërguar asnjë informacion mbi ecurinë e procedurave të ndjekura nga ana e ISHMP në lidhje me këto procesverbale, gjë e cila do të mundësonte ndjekjen e mëtejshme të procedurave nga ana AKZM-së, *(trajtuar në faqet 75-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

***Sa më sipër, është rekomanduar:***

- Nga AKZM çdo 6 mujor të kryhet rakordim me Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit mbi ecurinë e kundërvajtjeve administrative të dërguara nga AdZM-të dhe AKZM.

Çdo plan ose projekt, që mund të ndikojë në zonë, i nënshtrohet procedurave ligjore të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Ministria e Mjedisit, AKM dhe AKZM të cilat janë përgjegjëse për mjedisin, pranojnë planin ose projektin, vetëm pasi të sigurohen se ai nuk ndikon negativisht në integritetin e zonës, si dhe pasi kanë marrë mendimin e publikut. Kur është e nevojshme në kuadër të planifikimit të përdorimit të tokës, këto organe u kërkojnë hartuesve dhe zbatuesve të planifikimit të tokës menaxhimin e veçorive të peizazhit, me rëndësi të veçantë për florën dhe faunën e egër.

***Vazhdimisht***

### **32. Gjetje nga auditimi**

Nga kontrolli vizual i objektit të “Qendrës së Vizitorëve Dajt”, rezultoi se gjendja e objektit rezulton me këto probleme:

- Objekti është në degradim e sipër nga faktorët atmosferikë, si shkak i dëmtimit të çatisë, si shkak i mos disiplinimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

- Objekti rezulton me dëmtime të çatisë dhe ulluqeve, ka pësuar çarje në themele, muret mbajtëse, të kolonave, të dyshemesë. Të gjitha muret mbajtëse rezultojnë me lagështirë të madhe, dëmtim të trarëve horizontal me tendence këputje, ndërsa çatia në shumë vende pikon nga lëvizja apo thyerja e tjegullave.

Janë bllokuar të gjitha tubacionet e shkarkimeve të ujërave të zeza, kërkohet ndërhyrje të menjëhershme për riparimin e këtyre tubacioneve. Sistemi elektrik dhe ai hidraulik është i dëmtuar. Çarja e themeleve dhe të mureve mbajtëse tregon edhe për punë me cilësi të dobët të këtij objekti nga subjekti ndërtues dhe njëkohësisht marrja në dorëzim e këtij objekti, *(trajtuar në faqet 75-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **Sa më sipër, është rekomanduar:**

- Nga AKZM në bashkëpunim me AdZM Tiranë të ngrihet një grup pune, duke përfshirë dhe inxhinierë ndërtimi për të llogaritur zërat e punimeve dhe vlerën përkatëse për rehabilitimin e Qendrës së Vizitorëve të Malit të Dajtit dhe mbi bazën e preventivit të rezultuar, për fondet përkatëse të nevojshme, të bashkëpunohet me Ministrinë e Mjedisit për përcaktimin e këtij investimi në listën prioritare të financimeve.

*Në vijimësi*

### **33. Gjetje nga auditimi**

Nga AdZM Tiranë për mungesë fondesh nuk është vënë në funksion sistemi i kamerave në postbllok si dhe instalimi i sistemit të ndriçimit në ambientin e jashtëm.

Në postbllok bëhet monitorimi dhe regjistrimi i të gjitha mjeteve që transportojnë lëndë drusore, nga pyjet e Tiranës, apo dhe jashtë tyre. Ky postbllok, ka një efektivitet të madh në parandalimin e kontrabandës së lëndës drusore, jo vetëm të peizazhit të mbrojtur, por dhe zonave të tjera të Bulqizës, Matit apo Librazhdit, *(trajtuar në faqet 75-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **Sa më sipër, është rekomanduar:**

- Nga AKZM dhe AdZM të shikohet mundësia financiare (dhe mbi bazën e të ardhurave nga postblloku) për të instaluar sistemin e kamerave në postbllok dhe sistemin e ndriçimit.

*Në vijimësi*

### **34. Gjetje nga auditimi**

Në AdZM Tiranë, rezulton se 13 subjekte kanë shfrytëzuar për disa vite gurin gëlqeror dhe aktualisht rezultojnë me aktivitet të ndërprerë, por që nuk kanë rehabilituar sipërfaqet e shfrytëzuara, në kundërshtim me ligjin nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, me pikën 6 të VKM nr. 402, datë 21.06.2006 si dhe me urdhrin e MM nr. 3, datë 17.05.2006 “Për planet e rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara nga guroret”, *(trajtuar në faqet 75-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **Sa më sipër, është rekomanduar:**

- Nga AKZM dhe AdZM Tiranë në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit të merren të gjitha masat organizative dhe ligjore që nga të gjitha subjektet që kanë shfrytëzuar

për një kohë të gjatë gurit gëlqeror në Malin e Dajtit, të kryhet rehabilitimi i zonave respektive sipas subjekteve përkatëse.

*Brenda muajit Qershor 2016*

### **35. Gjetje nga auditimi**

Në Malin e Dajtit nga AdZM Tiranë nuk ka përfunduar evidentimi i objekteve të ndërtuara pa leje, (trajtuar në faqet 75-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Sa më sipër, është rekomanduar:**

-AKZM dhe AdZM Tiranë në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit të ushtrojnë kontroll për të evidentuar të gjitha ndërtimet pa leje brenda Zonës së Mbrojtur dhe të marrin masat e nevojshme proceduriale sipas dispozitave ligjore në fuqi.

*Brenda muajit Qershor 2016*

### **36. Gjetje nga auditimi**

Në zonën Kune-Vain, stuhitë dhe valët e fuqishme të shkaktuara nga këto erëra janë dy faktorët kryesorë të lidhura me klimën që ndikojnë tek dunat ranore përgjatë zonës së derdhjes së lumenjve Drin e Mat (DLDM). Deti avancon drejt tokës mesatarisht me 2.5 m në vit përgjatë bregdetit të Lezhës. Kështu, sipërfaqe të konsiderueshme të këtyre habitateve dhe florës e vegjetacionit të rëndësishëm të tyre ka humbur. Ndryshimet klimatike do të përkeqësojnë ndjeshëm rreziqet ekzistuese të tilla si përmytjet nga ciklonet dhe stuhitë detare. Rreziqet e tjera të lidhura me klimën, rritja e nivelit të detit, depërtimi i ujit të kripur në ujërat nëntokësore, thatësira, ndryshimi i pritshëm në regjimin e temperaturave, pritet të bëhen rreziqe më serioze për sigurimin e ushqimit, ujit, energjisë dhe shëndetit të njerëzve, (trajtuar në faqet 75-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Sa më sipër, është rekomanduar:**

Nga AKZM dhe AdZM qarku Lezhë, të kryhet një studim fizibilitetit të zonës me të gjitha efektet negative të klimës duke marrë të gjitha masat për:

- shtimin e bimësisë në zonën bregdetare nëpërmjet mbjelljes me pisha mesdhetare (e butë, e egër dhe pisha e detit) duke e shoqëruar me mbjelljen e bimësisë si bar pionier etj, në mënyrë që të favorizojë shtimin dunave natyrorë si dhe të krijojë mundësinë e mbrojtjes nga erozioni detar.
- Shmangien në mënyrë kategorike e ndërhyrjeve vertikale në det, përfshi dhe ato mbi Portin e Shëngjinit, me përjashtim të vetë portit i cili përfaqëson një gji natyror.
- Përveç aspekteve të kontrollit nga ana e rojeve mjedisore duhet punuar edhe në drejtim të luftës kundër zjarreve. Me ardhjen e stinës së verës, duhet kërkuar që në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe me institucionet e tjera, marrjen e masave mbrojtëse për parandalimin e zjarreve në pyje dhe kullota në zonat e mbrojtura si:
  - Ngritjen e sistemit të vrojtimit sinjalizimit për parandalimin e rënies së zjarreve në zonat e mbrojtura;
  - Skema dhe grafikët të skuadrave zjarrfikëse të AdZM-ve në qarqe në bashkëpunim me pushtetin vendor;
  - Bashkëpunimin me strukturat lokale e të specializuara para fillimit të zjarreve.
- Të gjitha ujërat e përdorura nga njësitë e shërbimit, duke qenë se kjo zonë është mbi basenin ujor të qytetit, detyrimisht duhet të kalojnë në deburator pastrimi.
- Të gjitha njësitë e shërbimit në mënyrë kategorike duhet të organizojnë sistemimin e mbetjeve urbane.

- Duhet të përshpejtohet mbyllja e ciklit dhe në standarde evropiane trajtimi i ujërave të zeza sipas metodës së zgjedhur të lagunazhit natyror.
- Të studiohet mundësia e spostimit të depozitave të karburanteve pranë kënetës së Kune Vainit.

*Vazhdimisht*

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

1. Është likuiduar subjekti “**XX**” më tepër për **14,645 lekë**, për furnizimin e AKZM me 8 670 litra naftë për të dy pagesat, përlllogaritja e gabuar e çmimit të bursës bazuar në buletin e APP dhe kursit të këmbimit të përdorur në llogaritje.

*Për këtë rekomandoj:* Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen *arkëtimet në vlerën 14,645 lekë* nga subjekti **XX**, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit, (trajtuar në faqet 58-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

*Menjëherë*

2. Është likuiduar shoqëria **XX** më tepër për **6,602 lekë**, për furnizimin e AKZM me 3692,5 litra benzinë nga përlllogaritja e gabuar e çmimit të bursës bazuar në buletin e APP.

*Sa më sipër, është rekomanduar:* Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen *arkëtimi i shumave 6,602 lekë* nga subjekti **X**, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit, (trajtuar në faqet 58-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

*Menjëherë*

3. Janë paguar në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës punës, brenda vendit” si dhe në kundërshtim me udhëzimin nr. 2 të Ministrisë së Financave datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 152, shpenzimet për udhëtim e djeta për 30 punonjës sipas tabelës bashkëlidhur.

*Sa më sipër, është rekomanduar:*

-Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen arkëtimi i shumave *në vlerën 204,000 lekë* nga 30 punonjësit, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit, , (trajtuar në faqet 46-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

*Menjëherë*

4. Nuk janë ndjekur dhe monitoruar zbatimi i kontratave të rezultuara nga dhënia me qira e ambienteve brenda rrjetit të zonave të mbrojtura, detyrim i ish DSHP, dhe aktualisht i AKZM, duke shkaktuar një detyrim të pa arkëtuar, të konstatuar nga grupi i auditimit për kontratat e audituara në shumën 6,847 mijë lekë për vitin 2014 dhe 2015 dhe 2,151.9 mijë lekë për kontrata në zonën e malit të Dajtit për detyrimet e papaguara për vitin 2015 sipas listimeve bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, në kundërshtim me parashikimet në kontratë. *Sa më sipër, është rekomanduar:*

-Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të arkëtohen shumat **në vlerën 8,998.9 mijë lekë** nga subjektet përkatëse, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit, *(trajtuar në faqet 10-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**Menjëherë**

( Për sa mësipër janë mbajtur procesverbali nr.2 datë 22.02.2016, nr.3, datë 22.02.2016, nr.4 datë 22.02.2016)

## **Për Kompetencë të Ministrisë së Mjedisit**

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

#### ***1. Gjetje nga auditimi***

Gjatë auditimit u konstatua se në kundërshtim me nenet 39 dhe 75 të ligjit nr. 9936, date 6.6.2008 “ Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nga Ministria e Mjedisit është mbajtur jashtë sistemit të thesarit, llogari e arkëtimit të të ardhurave për kontratat e lidhura nga DSHP, ku për kontratat në vazhdim dhe ato të lidhura gjatë vitit 2015 do të jetë administruese dhe monitoruese AKZM. Kjo llogari e hapur që në vitin 1998 me aktet përkatëse, me hyrjen në fuqi të ligjit të mësipër duhej të mbyllej, në një kohë që vazhdon të jetë e hapur dhe në momentin e auditimit të AKZM. Gjithashtu u konstatua se për shumat e arkëtuara dhe depozituara në llogarinë jashtë thesarit, e cila në fund të vitit 2014 kishte një gjendje prej 184.7 milion lekë dhe në fund të vitit 2015 kishte një gjendje 326. 57 milionë lekë, nuk ka përdorime për një pjesë të konsiderueshme të arketimeve për vitin 2014 dhe për asnjë arkëtim të realizuar gjatë vitit 2015, përdorim i cili duhej të bëhej sipas destinacioneve të përcaktuara në ligjin nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”. Këto fonde kanë mbetur në llogarinë jashtë sistemit, në një kohë që nga fondet buxhetore të çelura për MM në kapitullin 1 dhe programet përkatëse për pyjet, janë përdorur shumat prej 60.98 milionë lekë në 2014 dhe 178.96 milionë lekë në vitin 2015. Gjithashtu është konstatuar se për fondet e arkëtuara në llogarinë jashtë thesarit në bankën e nivelit të dytë, nuk janë aplikuar nga banka interesa për vitin 2014 dhe 2015 në ndryshueshmëri me vitet e mëparshme, *sa trajtuar në faqet 10-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*.

#### ***Sa më sipër, është rekomanduar:***

-Nga Ministria e Mjedisit të mbyllet në mënyrë të menjëhershme llogaria jashtë sistemit të thesarit konform akteve në fuqi, ku shumat gjendje në llogari të transferohen në sistemin e thesarit.

- Nga Ministria e Mjedisit konform marrëveshjeve që ka Ministria e Financave me bankat e nivelit të dytë për veprimet me qeverinë dhe konform përcaktimeve të hapjes së llogarisë rrjedhëse në vitin përkatës, të kërkohet aplikimi i interesave për shumat e pa aplikuar, për një pjesë të arketimeve të vitit 2013, për arkëtimet e vitit 2014, 2015 dhe 2016.

- Nga AKZM në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, referuar kontratave në administrim të saj, të njoftojnë zyrtarisht subjektet e kontraktuar me kontrata në fuqi, për numrat e llogarisë ku do të depozitohen këto të ardhura, *brenda sistemit të thesarit*.

- Nga AKZM në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, në kuadrin e ndryshimeve të tjera ligjore në përcaktimin e kompetencave të AKZM për pyjet dhe zonat e mbrojtura, të përcaktohen gjithashtu e drejta e përdorimit të të ardhurave në drejtim të financimeve për



mbrojtjen, përmirësimin, mirë menaxhimin të ZM në përputhje me objektivat, qëllimin dhe funksionet e përcaktuara për AKZM në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 4.02.2015.

*Menjëherë*

## **B. MASA DISIPLINORE**

**B1.** Mbështetur në nenin 58 "llojet e masave disiplinore", të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", nenit 57 si dhe nenit 59 të ligjit , gjithashtu mbështetur në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil",

-“ **Mbajtja 1/3 e pagës së plotë për një periudhë 6 mujore ” neni 58, germa b ose masën “Mos ngritje në detyrë për dy vjet” neni 58, germa c, në bazë të analizës për rezultatet e auditimit të paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit në AKZM për:**

**a. zX** me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe N/A i AKZM për arsye se:

-Për mos administrimin e kontratave dhe dokumentacionit teknik në kohë të shoqëruar edhe me detyrime si dhe mos zbatimin e urdhrin të ministrit, pasi z. Zamir Dedej, me veprimet dhe mosveprimet e tij ka bërë që procesi i dorëzimit të plotë të dokumentacionit teknik dhe kontratave edhe pse ka pasur një afat, të mos ketë përfunduar ende. Gjithashtu megjithë identifikimin e problematikave në zonat e mbrojtura, mos marrjen e masave duke mos përcjell këtë problematikë institucioneve të tjera vendimmarrëse.

-Në lidhje me biletat e vizitorëve, mos Identifikimi dhe Administrimi në kohë i tyre ka sjellë mos menaxhim të mirë të zonave të mbrojtura duke u shoqëruar dhe me mos gjenerimin e të ardhurave nga biletat.

- Për shkëljet e konstatuara në kryerjen e pagesave për pagat e punonjësve të AdZM në kundërshtim me aktet në fuqi me efekt dëmi prej 7,088,821 lekë, veprim që bie në kundërshtim me vendimin nr. 552 datë 11.08.2011, lidhja 2 “ Për pagat dhe shtesat mbi page të punonjësve të shërbimit pyjor ”, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave vendimit nr. 717, datë 26.06.2009 i ndryshuar me vendimin nr. 610, datë 24.07.2013 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore” lidhja 1 për institucioneve buxhetore qendrore, në varësi të ministrave të linjës.

-Për përlogaritjen e fondit limit të nevojave për karburant, pasi nuk kishte caktuar grupin për përgatitjen e kërkesës, specifikimeve teknike dhe sasisë e nevojshme, për benzinën dhe naftën, në bazë të mjeteve dhe të planifikimit të detajuar të lëvizjeve të kryera duke justifikuar Km e përshkuara.

-Nga AK, nuk ishte bërë studimi i tregut për përcaktimin e çmimit për naftën dhe benzinën, pasi nga titullari nuk ishte ngritur Grupi Punës për Testimin e Tregut (GPTT)

**B2.** Mbështetur në nenin 58 "llojet e masave disiplinore", të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", nenit 57 si dhe nenit 59 të ligjit , gjithashtu mbështetur në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", dhe duke qenë se AKZM është në proces për Statusin e Nëpunësit Civil , ju rekomandoj marrjen e masave për punonjësit e mëposhtëm të AKZM.

-“ **Mbajtja 1/3 e pagës së plotë për një periudhë 6 mujore ” neni 58, germa b në bazë të analizës për rezultatet e auditimit të paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit në AKZM për:**

a. **XX** me detyrë Drejtores e Menaxhimit të Projekteve dhe Monitorimit , për arsye se:

- Për mosadministrimin e kontratave dhe dokumentacionit teknik në kohë të shoqëruar edhe me detyrime si dhe mos zbatimin e urdhrat të ministrit, pasi znj. Adriana Petri, ka detyrë funksionale si drejtori referuar rregullores së brendshme të miratuar, mbajtjen dhe administrimin e dokumentave të aktiviteteve private brenda territorit të zonave të mbrojtura.  
-Për mos krijimin në kohë të një database të plotë të dhënash për të gjitha kontratat e lidhura kompetencë e DSHP-ve dhe aktualisht të AdZM dhe AKZM si dhe detyrimeve që rrjedhin prej tyre .

**-“ Mbajtja 1/3 e pagës së plotë për një periudhë 2 mujore ” neni 58, germa b në bazë të analizës për rezultatet e auditimit të paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit në AKZM për:**

b. **X** me detyrë Drejtores Ekonomike dhe e Shërbimeve dhe N/Z për arsye se:

- Për mos mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2015 në kundërshtim me afatet e përcaktuara në udhëzimet e Ministrisë së Financave, veprim që bie në kundërshtim me Udhëzimin nr. 14 datë 28.12.2006 të ndryshuar.
- Për moskryerje të inventarit të aktiveve të institucionit në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011.
- Për shkeljet e konstatuara në pagesat e dietave të punonjësve me mungesë dokumentacioni si dhe jo konform kërkesave të përcaktuara në aktet në fuqi, veprim që bie në kundërshtim me vendimin të KM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës punës, brenda vendit.
- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e pagesave për pagat e punonjësve të AdZM në kundërshtim me aktet në fuqi, veprim që bie në kundërshtim me vendimin nr. 552 datë 11.08.2011, lidhja 2 “ Për pagat dhe shtesat mbi page të punonjësve të shërbimit pyjor ”, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave vendimit nr. 717, datë 26.06.2009 i ndryshuar me vendimin nr. 610, datë 24.07.2013 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore” lidhja 1 për institucioneve buxhetore qendrore, në varësi të ministrave të linjës dhe ku për periudhën objekt auditimi është shkaktuar një dëm ekonomik në shumën rreth 7,088,821 lekë.
- Për shkelje procedurash në shpenzimet e realizuara nëpërmjet bankës për shpenzimet e kryera me prokurim elektronik për blerjet me vlera të vogla dhe mungesë dokumentacioni justifikues për disa raste sipas trajtimit hap pas hapi në Raportin përfundimtar të auditimit.

(Sa më sipër janë mbajtur procesverbalet me nr. 1, datë 22.02.2016, nr.2 datë 22.02.2016, nr. 4 datë 22.02.2016, procesverbal nr.3, datë 22.02.2016, aktverifikimi nr.2/1 datë 4.03.2016 )

**Shënim:** Për ish drejtorët e DSHP Qarku Gjirokastrë **XXX dhe XX** ish drejtorët DSHP Qarku Vlorë **XX dhe XX** ish drejtorët e DSHP Qarku Tiranë **XX dhe XX** ish drejtorët e DSHP Korçë **XX dhe XX**, për ish drejtorët e DSHP Qarku Berat **XX dhe XX**, ish drejtori i DSHP Qarku Kukës **XX**, ish Drejtori i DSHP Qarku Shkodër **XX** dhe ish drejtori i DSHP Qarku Dibër **Z.Li**, do të propozonim **“Largim nga detyra”** pasi kanë lidhur kontrata në zonë të mbrojtur, sipas përcaktimeve për çdo qark të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit si dhe nuk kanë ndjekur detyrimet e kontratave, por meqenëse të gjithë personat e sipërcituar nuk janë më në marrëdhënie pune ( pasi DSHP janë shkrirë si institucione dhe këto punonjës nuk janë pjesë e stafit të AKZM dhe AdZM) mendoj që masa disiplinore të konsiderohet e ezauruar.Ministria e Mjedisit të njoftojë DAP –in për këto propozime për masën “ Largim nga detyra”.

(Sa më sipër janë mbajtur procesverbalet me nr.2 datë 22.02.2016)

**Për kompetencë të Ministrisë së Financave**

**MASA DISIPLINORE**

Gjatë auditimit në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura referuar të ardhurave të realizuara nga kontratat e lidhura me subjekte private për dhënien në shfrytëzim të pyjeve dhe kullotave këto dhe në Zonat e Mbrojtura dhe auditimit përdorimit të të ardhurave për qëllimet e përcaktuara nga ligji rezultoi se në kundërshtim me nenet 39 dhe 75 të ligjit nr. 9936, datë 6.6.2008 “ Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nga Ministria e Mjedisit është mbajtur jashtë sistemit të thesarit, llogari e arkëtimit të të ardhurave për kontratat e lidhura nga DSHP, ku për kontratat në vazhdim dhe ato të lidhura gjatë vitit 2015 do të jetë administruese dhe monitoruese AKZM. Kjo llogari e hapur që në vitin 1998 me aktet përkatëse, me hyrjen në fuqi të ligjit të mësipër duhej të mbyllej, në një kohë që vazhdon të jetë e hapur dhe në momentin e auditimit të AKZM. Gjithashtu u konstatua se për shumatat e arkëtuara dhe depozituara në llogarinë jashtë thesarit, e cila në fund të vitit 2014 kishte një gjendje prej 184.7 milion lekë dhe në fund të vitit 2015 kishte një gjendje 326. 57 milionë lekë, nuk ka përdorime për një pjesë të konsiderueshme të arkëtimeve për vitin 2014 dhe për asnjë arkëtim të realizuar gjatë vitit 2015, përdorim i cili duhej të bëhej sipas destinacioneve të përcaktuara në ligjin nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”. Këto fonde kanë mbetur në llogarinë jashtë sistemit, në një kohë që nga fondet buxhetore të çelura për MM në kapitullin 1 dhe programet përkatëse për pyjet, janë përdorur shumatat prej 60.98 milionë lekë në 2014 dhe 178.96 milionë lekë në vitin 2015. Gjithashtu është konstatuar se për fondet e arkëtuara në llogarinë jashtë thesarit në bankën e nivelit të dytë, nuk janë aplikuar nga banka interesat për vitin 2014 dhe 2015 në ndryshueshmëri me vitet e mëparshme. Nga grupi i auditimit për AKZM dhe Ministrinë e Mjedisit janë lënë rekomandimet, *të cilat duhet të jenë dhe në vëmendjen dhe dijeninë tuaj*, si më poshtë vijon :

-Nga Ministria e Mjedisit të mbyllet në mënyrë të menjëhershme llogaria jashtë sistemit të thesarit konform akteve në fuqi, ku shumatat gjendje në llogari të transferohen në sistemin e thesarit.

- Nga Ministria e Mjedisit konform marrëveshjeve që ka Ministria e Financave me bankat e nivelit të dytë për veprimet me qeverinë dhe konform përcaktimeve të hapjes së llogarisë rrjedhëse në vitin përkatës, të kërkohet aplikimi i interesave për shumatat e pa aplikuar, për një pjesë të arkëtimeve të vitit 2013, për arkëtimet e vitit 2014, 2015 dhe 2016.

- Nga AKZM në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, referuar kontratave në administrim të saj, të njoftojnë zyrtarisht subjektet e kontraktuar me kontrata në fuqi, për numrat e llogarisë ku do të depozitohen këto të ardhura, *brenda sistemit të thesarit.*

- Nga AKZM në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, në kuadrin e ndryshimeve të tjera ligjore në përcaktimin e kompetencave të AKZM për pyjet dhe zonat e mbrojtura, të përcaktohen gjithashtu e drejta e përdorimit të të ardhurave në drejtim të financimeve për mbrojtjen, përmirësimin, mirë menaxhimin të ZM në përputhje me objektivat, qëllimin dhe funksionet e përcaktuara për AKZM në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 4.02.2015.

*Në lidhje sa më sipër cituam dhe trajtimin më të zgjeruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit të cilin po Ju a vendosim bashkëlidhur , **rekomandoj** marrjen në analizë dhe përcaktimin e përgjegjësisë së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit*

**XX** në pozicionin e “Nëpunësit Autorizues” të Ministrisë së Mjedisit për shkeljet e neneve 39 dhe 75 të ligjit nr. 9936, date 6.6.2008 “ Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” në procesin e mbajtjes hapur të llogarisë jashtë sistemit të thesarit si dhe depozitimit të këtyre fondeve dhe mospërdorimit të tyre konform destinacioneve të përcaktuara në ligjin nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, në një kohë që për këto destinacione janë përdorur fonde të çelura nga buxheti i shtetit “kapitulli 01 i financimeve buxhetore”, pra jo nga financime nga të ardhurat” dhe kur këto të ardhura kanë qenë të depozituara pa interes, në llogari jashtë sistemit të thesarit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në vendimin Nr. nr. 47, date 30.04.2016 ngarkohet Departamenti i Auditimit të Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Shënim: Auditimi u krye përgjatë periudhës 7.01.2016 deri me datën 13.03.2016, nga grupi i auditimit Nikoleta Piranjani përgjegjese grupi, Yllka Dede, Migena Nushi, Sazan Guri, Pëllumb Beqiri, Koço Sokoli anëtarë, më tej u shqyrtua nga k/auditues Selfo Zeneli, Drejtori i Departamentit Alush Zaçe dhe Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve z. Ermal Yzeiraj.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**